



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 11. 10. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Vjosa Osmani, Fatmir Xhelili, Bislim Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Xhavit Haliti-(udhëtim zyrtar), Arben Gashi, Valdete Bajrami, Kujtim Paqaku dhe Slobodan Petroviq.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e Komisionit, znj. Njomza Emini.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.08.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit datës 9.08.2016

Procesverbali i datës 9.08.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja e Komisionit, Njomza Emini prezantoi opinionin ligjor lidhur me Projektligjin.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për çështjet e kamatëvonesave në transaksionet tregtare, është e mbuluar me:

- Direktivën 2011/7/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, për “Luftën Kundër Pagesave të Vonuara në Transaksionet Tregtare”.

Gjatë shqyrtimit dhe verifikimit është vlerësuar se Projektligji nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së, përkatësisht të Acquis të BE-së. Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Lidhur me Projektligjin e hapi debatin.

Kryetarja, pasi nuk kishte vërejtje nga anëtarët, konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Të ndryshme

Kryetarja, pasi nuk kishte çështje të ngritur për diskutim, e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini